



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 67 datë 30.12.2015

Për

**“MIRATIMIN E TERMAVE KRYESORE TË KONTRATËS KONCESIONARE MBI
PARKIMIN NËNTOKËSOR NË PARKUN “RINIA””**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3/I, shkronjat “d” dhe “ë”, nenit 32, shkronjat “e”, “f” dhe “k” dhe nenit 33, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 48 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 për “Koncesionet dhe partneritetin publik privat” (i ndryshuar); ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1181, datë 23.07.2008 për “Përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion vendor të parkimit nëntokësor, në parkun “Rinia”, Tiranë, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë të qarkut të Tiranës”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 30.9.2015 “Për shfuqizimin e vendimit nr.1233, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të sipërfaqes së truallit të parkut “Rinia”, Tiranë”; udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 për “Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.36, datë 29.09.2008 për “Përcaktimin e formës së dhënies me koncesion të dy parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës”; Raportin Përmbledhës me nr.prot.4663, datë 20.05.2009, mbi “Vlerësimin e ofertave për “Dhënien me koncesion vendor të parkimit nëntokësor në parkun “Rinia”, Tiranë”; shkresës nr.prot.4207, datë 06.05.2009, të Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, drejtuar shoqërisë “Taiëan” shpk, për “Njoftim mbi vlerësimin dhe klasifikimin e shoqërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tiranë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë termat kryesore të kontratës koncesionare për parkimin nëntokësor në Parkun “Rinia”, i cili do të realizohet nga koncesionari, shoqëria “Taiëan” shpk, sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Koncesionari do të realizojë punimet mbi bazën e kontratës koncesionare dhe sipas procedurave ligjore në fuqi për planifikimin e territorit, tek Parku “Rinia”, me numër pasurie 7/187, në zonën kadastrale nr. 8380.
3. Koncesionari detyrohet që, pas ndërtimit të objektit dhe përpara fillimit të operimit të shërbimit, të realizojë punimet që të kthejnë mbitokën në destinacionin aktual, përkatësisht në park.
4. Koncesionari ndalohet të kolateralizojë për efekt financimi të investimit dhe shërbimit, truallin dhe objektin ndërtimor, pasuri të cilat mbeten të lira nga çdo barrë dhe risk përgjatë periudhës koncesionare.
5. Të kryhet kontabilizimi i vlerave të investimeve përkatësisht për Parkun “Rinia”, me numër pasurie 7/187, në zonën kadastrale nr. 8380. Të reflektohen ndryshimet kontabël duke zbritur vetëm vlerat përkatëse të investimeve që rezultojnë brenda sipërfaqes, që do të jepet me koncesion dhe do të ndjekë procedurat ligjore për dorëzimin e saj ndaj koncesionarit. Me përfundimin e ndërtimit të parkimit nëntokësor dhe rikthimin në destinacionin aktual të sipërfaqes së mbitokës, koncesionari do bëjë kalimin e vlerave përkatëse kontabël Bashkisë së Tiranës.
6. Koncesionari në përfundim të Kontratës Koncesionare, i kalon Bashkisë së Tiranës pronën sipas genplanit bashkëlidhur.
7. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Tiranë të nënshkruaje kontratën koncesionare sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe procedurave ligjore.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen strukturat e Bashkisë së Tiranës.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikës 6 të nenit 33 të Ligjit Nr. 8652, datë 30.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (*i ndryshuar*) dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI

Aneksi 1.

**TARIFAT REFERENCË TË PARKIMEVE NËNTOKËSORE SI DHE PAJTIMET
PERIODIKE
Për subjektin "Taiëan"
Parku "Rinia"**

NR.	KRITERET	OFERTA
1	TARIFA E PARKIMIT	ORA I 120 lekë/orë ORA 2-4 50 lekë/30 min ORA 4-8 40 lekë/30 min ORA 8-12 40 lekë/30 min Biletë ditore 850 lekë Biletë nate 22-07 500 lekë Biletë mujore 12.000 lekë Biletë 3 mujore 34.000 lekë Biletë 6 mujore 60.000 lekë
2	TARIFA KONCESIONARE	15% e fitimit
3	NUMRI MAKSIMAL I VENDPARKIMEVE TOTAL	1342
4	NUMRI MAKSIMAL I VENDPARKIMEVE PËR KATEGORI TE VECANTA	Invalidët 30 vende Institucionet publike 140 vende Rezidentë 160 vende Biznesi 73 vende
5	TARIFAT E POSACME E PARKIMIT PER KATEGORI TË VECANTA	Invalidët falas Inistitucione publike 6.000 lekë/ muaj Rezidentë 10.000 lekë/ muaj Biznesi 12.000 lekë/ muaj
6	KOHA E VËNIES NË SHFRYTËZIM TË VEPRËS	15 muaj
7	KOHËZGJATJA E KONCESIONIT	30 vjet
8	VLERA E INVESTIMIT	1.937.932.800 lekë